Në vijim të kërkesës suaj për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe të dhënave që lidhen me pjesëmarrjen tuaj në procedurën e konkurrimit për pozicionin, #7839- Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Inxhinierike/Shkenca Natyrore", niveli minimal i diplomës "Master Profesional", Departamenti i Administratës Publike (DAP), bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Procedura e konkurrimit për kodin 7839 aktualisht është në proces dhe më konkretisht në fazën e shqyrtimit të ankesave pas përfundimit të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, në zbatim të pikes 6, të kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar. https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/7541/2/4.

Ashtu sikur jeni njoftuar individualisht me email në datën 22.09.2026, ju jeni kualifikuar për të vijuar në fazën e dytë të konkurrimit. Gjithashtu jeni informuar se testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 9.10.2026, ora 13:00, kurse intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë 16.10.2026, ora 10:00, në ambientet e DAP.

Për rrjedhojë testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë për procedurën e konkurrimit 7839 nuk janë zhvilluar ende.

Në kuptim të sa më sipër, ju do të njoftoheni individualisht me email mbi ecurinë e procedurës së konkurrimit si dhe nëpërmjet faqes zyrtare të DAP.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 27, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,